


Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore

Viti 2024

Tiranë, më 03 Korrik 2025: Në vitin 2024, indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve bujqësore arriti në 149,6 nga 142,8 që ishte në 2023, duke shënuar një rritje me 4,8 %. Gjatë këtij viti, indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore shënoi rritje me 9,1 %, gjithashtu rritje ka shënuar edhe indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale me 0,4 %, krahasuar me një vit më parë.

Fig. 1 Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore, (2015=100)



Burimi: Anketa mujore për Produktet Bujqësore, INSTAT

Për më shumë informacion dhe për të parë tabelat e detajuara, vizitoni bazën e të dhënave në faqen zyrtare të INSTAT: [Çmimet e Prodhimeve Bujqësore](#)

Për publikim 03/07/2025

Metodologjia

Indekset e çmimeve të prodhimeve bujqësore llogariten bazuar në standartet dhe rregullat e përshkuara në Manualin e Çmimeve të Produkteve Bujqësore të Eurostat. Çmimet mbledhen nga Anketa Mujore për Produktet Bujqësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Mbledhja e të dhënave kryhet pranë fermave, tregjeve të gjësë së gjallë, tregjeve të shumicës dhe vende të tjera ku prodhimet bujqësore mund të grumbullohen. Informacioni merret vetëm për çmimet në nivel ferme për produktet vendase, duke përjashtuar taksat. Ato janë mbledhur në Lek. kurse njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë sipas produktit.

Prodhimet që krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të produkteve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore dhe ato blegtorale. Për prodhimet bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë industriale, bimë foragjere, perime, patate dhe drufrutorë. Për prodhimet blegtorale, çmimet janë grumbulluar për mishin peshë e gjallë dhe prodhimet blegtorale. Çmimet e mishit peshë e gjallë grumbullohen për katër kategori kryesore të kafshëve: gjedhi, të imta, derra dhe shpendë. Për prodhimet blegtorale, çmimet janë grumbulluar për kategoritë: qumësht, vezë dhe mjaltë.

Skema e peshave në Indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore

Për llogaritjen e indeksit të çmimeve të produkteve bujqësore përdoret një skemë e mirëpërcaktuar peshash. Vlera e peshës bashkëngjitur në çdo indeks elementar dhe në indeksin e agreguar është e barabartë me vlerën e shitjes së produkteve (pa përfshirë TVSH) gjatë periudhës bazë (2015=100), bazuar kjo në metodologjinë ndërkombëtare. Peshat përdoren gjithashtu dhe për të bashkuar nëngrupet e indekseve në nivel grupi dhe për të agreguar indeksin në nivel grupi duke prodhuar indeksin vjetor. Peshat e çmimeve të produkteve bujqësore janë konform parimeve të Llogaritjes Ekonomike në Bujqësi (në konceptin e çmimeve të prodhimit). Skema e peshave për Indeksin e Çmimeve Bujqësore ndryshon çdo 5 vite. Gjatë kësaj periudhe peshat totale dhe peshat tremujore të çmimeve të produkteve bujqësore nuk ndryshojnë.

Llogaritja e indeksit elementar të çmimeve

Indeksi elementar llogaritet sipas formule në vijim duke përdorur çmimet mesatare absolute.

$$R_i^t = \frac{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^t}{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^0} \cdot 100$$

R_i^t : Indeksi elementar për muajin "t" dhe prodhimin "i"

P : Çmimet e grumbulluara

i : Prodhimi "i"

j : Çmimi i regjistruar për prodhimin (në përgjithësi çmimi për rrethin 1.2.....n)

t : Muaji i vëzhguar

o : Muaji bazë

Llogaritja e indeksit të agreguar të çmimeve

Indeksi të agreguar për totalin e prodhimeve ose nëngrupeve të indeksit të prodhimeve është llogaritur duke shfrytëzuar formulën në vijim:

$$I^t = \sum \left(R_i^t \cdot \frac{w_i^o}{\sum w_i^o} \right) \cdot 100$$

I : Indeksi i agreguar për periudhën "t"

w_i^o : Faktori peshues në periudhën bazë për prodhimin "i"

i : Prodhimi "i"

t : Muaji i vëzhguar

o : Muaji bazë